



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 195, Datë 19.06.2023

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “EU GREEN
ENERGY” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.06.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1271/4 prot., datë 16.06.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “EU GREEN ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “EU GREEN ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1271 prot., datë 18.04.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. ERE, me e-mailin e datës 26.04.2023, i evidentoi shoqërisë gjetjet e saj pas dorëzimit të aplikimit dhe dokumentacionin plotësues që duhet të përcillte në kuadër të aplikimit. Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1271/2 prot., datë 02.05.2023, depozitoi dokumentacion plotësues për t’u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Nga shqyrtimi i dokumentacionit u evidentua se shoqëria nuk ishte e qartë, për këtë arsye më datë 05.06.2023 ERE zhvilloi një seancë dëgjimore me shoqërinë. Në vijim të seancës dëgjimore, shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1273 prot., datë 06.05.2023, paraqiti dokumentacion plotësues për aplikimin.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); Shtojcën 1 dhe Shtojcën 1/E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (Aneksi A).
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “EU GREEN ENERGY” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “c” dhe “d” dhe për pikën 1.3, gërmën “a” .
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se nevojitet të plotësohet dhe dokumentacioni në vijim:

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacion mbështetës të financimit të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike për të paktën 1 muaj.
- **gërma “c”:** Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE planin e biznesit të dedikuar për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Pika 2.5. Shoqëria duhet të nënshkruajë dhe/ose të vulosë dokumentin mbi sasinë e energjisë elektrike që parashikon të tregtojë.

- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “EU GREEN ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI